



Prishtinë, 10 shtator 2010
Kodi i ZRRE-së: V_291_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Nenin 13 paragrafi 2 dhe Nenin 38 paragrafi 7 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike;
3. Kërkesën për amendamentim të disa dispozitave të Kodit të Matjes, dërguar nga Komisioni për Qeverisjen e Kodeve Operacionale (KQKO) të datës 15 janar 2010;

Në seancën e mbajtur më 10 shtator 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN amendamentimet e disa dispozitave të Kodit të Matjes, (si në SHTOJCË të këtij vendimi).

Arsyetim

1. ZRRE ka pranuar kërkesën për amendamentim të disa dispozitave të Kodit të Matjes dërguar nga Komisioni për Qeverisjen e Kodeve Operacionale (KQKO) me datë 15 janar 2010.
 2. Amendamentimet në këtë Kod, fillimisht janë iniciuar dhe prezantuar nga KOSTT Sh.a dhe më pastaj nga KQKO.
 3. ZRRE ka dhënë komente në këtë Kod, dhe pas këtyre komenteve janë bërë ndryshime shtesë, e të cilat ZRRE i ka analizuar dhe vlerësuar dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi dhe analizimin përfundimtar të Kodit, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 4. Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të Kodit të Matjes mbesin në fuqi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
 - III. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

SHTOJCË: **“Amendamentimet e Kodit të Matjes”.**

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar

